



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.18, datë 12.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “KËRKESË PËR RINOVIMIN E
KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”, SUBJEKTIT “BALLEJ-
A” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor të përroit Thekna për qëllime teknologjike (për Uzinën e Ferrokromit) me Nr.serie:0002, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.02, datë 22.09.2017, subjektit “Ballej-A” sh.p.k, me vendndodhje, Njësia AdministrativMartaneshe , Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH): Përroi i Thekna

- X=520316
- Y=4587116
- Z=992 m.m.n.d

- Prurja mesatare : $Q_{mes} = 5 \text{ l/s}$
- Sasia e ujit në përdorim : $Q = 0,7 \text{ l/s}$
- Qëllimi i përdorimit : Ujë për proces teknologjik në Uzinën e Ferrokromit
- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Përroi Thekna degë e lumit Mat

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

